



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT (GLLOGOC)
Zyra e Kuvendit të Komunës

12 Nr. *501 - 1468* dt. *27.12.2012*

Në vështrim të nenit 12 dhe 40.2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit nr 04/L-060 për mbeturina dhe nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt. 21.12.2012, miratoi:

RREGULLORE

Për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Drenasit

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimet dhe detyrat

1. Me këtë rregullore përcaktohet kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndotjet dhe rreziqet që vijnë nga mbeturinat, duke i krijuar kushtet për parandalimin dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar të mbeturinave dhe shkallën e rrezikshmërisë;
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përmisojë sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Drenasit
3. Detyrat përshkruajnë të gjitha aktivitetet në lidhje me menaxhimin e mbeturinave të cilat do të zbatohen nga Komuna e Drenasit.
4. Komuna me këtë Rregullore rregullon sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimin, orarin për mbledhjen e mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrat për transportim të mbeturinave komunale
5. Komuna është e obliguar për trajtimin e mbeturinave komunale nga konstruktiv demoli si dhe mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshëm brenda territorit të Kosovës
6. Masat e largimit të mbeturinave janë masat e domosdoshme për dorëzimin, mbledhjen përmes transportit, trajtimin dhe deponimin e tyre.
7. Obligimi tjetër i Komunës është informim për vetëdijësimin e qytetarëve rreth zvogëlimit të sasisë, ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave.
8. Mbeturinat do të mbledhen dhe ndahen në atë mënyrë që së pari të mund të krijohen mundësitë e riciklimit të tyre.

Neni 2

Operatori për menaxhimin e mbeturinave

1. Detyrat në menaxhimin e mbeturinave të amvisërisë zbatohen nga Operatorët e licencuar dhe të kontraktuar nga Komuna
2. Operatori i kontraktuar nga Komuna për menaxhimin e mbeturinave duhet:
 - të jetë i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
 - të ketë hapësirë të mjaftueshme për pajisjet e nevojshme për këto shërbime
 - të ketë kapacitete njerëzore dhe teknike për kryerjen e këtyre shërbimeve
 - të ketë leje operimi të lëshuar nga Komuna

Neni 3

Përkufizimet:

1. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedh;
2. **Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
3. **Operatori** - personi, i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve;
4. **Kompostimi** - trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara;
5. **Licenca për menaxhimin e mbeturinave** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas këtij ligji;
6. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;
7. **Përpunim i mbeturinave** – operim, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impianti apo ekonominë e gjerë.
8. **Trajtimi** - përpunimi apo deponimi përfundimtar, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose deponimit përfundimtar.

9. **Reciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
10. **Implant - objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;**
11. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;
12. **Përdorimi i mbeturinave** - çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar
13. **Përgatitja për ri-përdorim** - operimet e përpunimit, kontrollimit, pastrimit apo riparimit, gjatë së cilave produktet apo komponentët e produkteve që janë bërë mbeturina janë përgatitur ashtu që ato mund të ripërdoren pa ndonjë para trajtim;
14. **Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale;
15. **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.
16. **Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;
17. **Parandalimi** - masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:
 - a) sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;
 - b) efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - c) përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.
18. **Ri-përdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë destinuar;
19. **Mbledhja** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;

20. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;

21. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën;

22. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;

23. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

- a) mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- b) i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

24. **Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makinerite, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë;

Neni 4

Përfashtimet

Nga kjo Rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:

- 1. mbeturinat e rrezikshme
- 2. Lumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme

Neni 5

Shërbimet publike dhe menaxhimi i mbeturinave

- 1. Te gjithë subjektet që në përputhje me natyrën e shërbimeve të tyre krijojnë lloje të ndryshme mbeturinash, duhet të bëjnë ndarjen e tyre.
- 2. Qerdhet dhe shkollat, publike e private, duhet të edukojnë nxenesit me rregullat bashkekohore të trajtimit të mbeturinave
- 3. Personat që kryejnë shërbime tregtare, hoteliere dhe shërbime tjera, detyrohen të mbajnë mjedisin e pastër për rreth objekteve, përfshirë edhe trotuarin para objektit.

4. Prodhuesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen tek operatori në listat e shërbimit të konsumatorëve, për shfrytëzim të mbledhjes dhe ndarjes të mbeturinave komunale.

5. Komuna duke zbatuar procedurat e prokurimit, përzgjedh operatorët e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;

Neni 6

Kontejnerët e mbeturinave

1. Komuna përcakton llojin, vëllimin, numrin dhe qëllimin e kontejnerëve të mbeturinave, si dhe periudhën kohore të mbledhjes.

2. Për mbledhje dhe ndarje të mbeturinave janë të aprovuara llojet vijuese të kontejnerëve dhe shportave:

3. Madhësia e kontejnerit-pesha maksimale e lejuar, lloji i mbeturinave, p.sh.

a) 1.1m³, 440 kg mbeturina të amvisërisë

b) 3.2m³ kontejnerë mbi dhe nëntokësor

c) 5m³, 4000 kg mbeturina inerte (ndërtimore, etj)

d) 7m³, 6000 kg për mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme

4. Madhësia e shportave për mbeturina të amvisërisë përcaktuar në litër:

a) 60 l

b) 80 l

c) 120 l

d) 240 l

5. Shporta të vëllimeve të ndryshme, të vendosura në trotuare dhe parqe

Neni 7

Qëllimi dhe shfrytëzimi i kontejnerëve/shportave

1. Qytetarët duhet të jenë të informuar mbi llojin e kontejnerëve të ofruar nga Komuna në bashkëpunim me operatorin si në vijim:

2. Qytetarët janë të obliguar që të shfrytëzojnë kontejnerët për hedhje dhe ndarje në mënyrë të përshtatshme

3. Hedhja e mbeturinave shtëpiake nga personat e objekteve të banimit kolektiv, bëhet në kontejnerët apo në vendet për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave
4. Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e banimit kolektiv dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.
5. Në shtëpitë dhe objektet private, amvisëritë duhet të kenë më së paku dy shporta për hedhjen e mbeturinave të ndara.
6. Njëra shportë shërben për hedhjen e mbeturinave organike, ndërsa tjetra shërben për mbeturina tjera të riciklueshme
7. Spitalet, ambulancat dhe objektet tjera për shërbime mjekësore duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale nga ato komunale

Neni 8

Ndalesat

Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ndalohet:

1. hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, në trotuare, sheshet e banuara apo në mjediset publike;
2. hedhja e mbeturinave e llojeve tjera në kontejnerë, shporta ose në pikat mbledhëse për mbeturinat komunale të cilat nuk ndahen si mbeturina komunale;
3. hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, terasat e banesave etj.);
4. përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve/shportave të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
6. hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
7. hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, lumenj dhe në vende tjera publike);
8. ndërrimi i vend ndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
9. djegia e mbeturinave në vende publike, kontejner/shporta, në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
10. shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët/shportat ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
11. shfrytëzimi i kontejnerëve/shportave publike nga bizneset ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturinat komunale dhe komerciale"

12. gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejner, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar ;
13. hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerit/shportës së mbeturinave;
14. derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
15. operatorët duhet të marrin masa, që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
16. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.
17. Mbeturinat nga paisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hudhen në kontejnerë të mbeturinave komunale ose në afërsi
18. Çdo ndryshim i kushteve nga paragrafi 8. i këtij neni duhet të miratohet me shkrim nga organet kompetente komunale, duke marrë parasysh kushtet teknike, higjienike dhe të mjedisit.

Neni 9

Kontejnerët/shportat për hedhje të mbeturinave

1. Kontejnerët/shportat për hedhje të mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme ku nuk shkaktojnë pengesë apo rrezik për lëvizje të lirë të qytetarëve dhe qarkullim të mallrave.
2. Kontejnerët/shportat duhet të jenë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që udhëzojnë hedhjen e ndarë të mbeturinave.
3. Kontejnerët në masën deri 1.1 m³ duhet të kenë mekanizëm mbyllës, dhe ata për ndarje kapak në kapak
4. Kontejnerët/shportat duhet të kenë sipërfaqe të lëmuara, lehtësisht të pastrohen dhe materiali i tyre (metal, plastik etj) duhet të jetë i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj ujit.
5. Kontejnerët/shportat për mbeturina duhet të jenë teknikisht të përshtatshëm për automjetet që bëjnë zbrazjen e mbeturinave.
6. Lokacionet e vendosjes së kontejnerëve/shportave i cakton Komuna në përputhje me planet rregullative
7. Kontejnerët dhe shportat e mbeturinave ofrohen në përdorim nga ana e Komunës, operatorit dhe palëve të treta të kontraktuara.

8. Orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave e përcakton Komuna në bashkëpunim me operatorin

9. Sipas nevojës Komuna autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës

10. Operatori, në bazë të marrëveshjes me komunën, vendos numrin e nevojshëm të kontejnerëve / shportave në hapësirat e objekteve të banimit kolektiv dhe individual.

11. Komuna, përcakton llojin e kontejnerëve/ shportave të përshtatshëm me tekniken me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i mbeturinave

Neni 10

Skema organizative dhe zona e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

1. Komunitat, miratojnë dhe publikojnë skemën organizative me strukturë dhe përmasë të shërbimit për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave për çdo vendbanim, lagje apo hapësirë ose sipërfaqe publike

2. Mbledhja dhe ndarja e mbeturinave prej rrugëve, shesheve, trotuareve dhe hapësirave ose vendeve brenda qytetit duhet të bëhet më së paku një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e vona të mbrëmjes.

3. Gjatë ditës, pastërtia brenda qytetit sigurohet duke grumbulluar dhe larguar mbeturinat nga sheshet, rrugët dhe trotuaret.

4. Mbledhja dhe ndarja e mbeturinave nga rrugët, sheshet, trotuaret dhe hapësirat ose sipërfaqet tjera në vendbanimet rurale, ku janë të vendosur kontejnerët / shportat me mbeturina duhet të kryhet brenda orarit të caktuar gjatë ditës.

5. Mbeturinat që krijohen gjatë pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe shesheve, operatori nuk duhet ti hedh në kontejnerë publikë për mbeturina komunale por duhet ti dërgoj në deponi

6. Komunitat brenda territorit administrativ, bënë përcaktimin e zonave për kryerjen e shërbimit për mbledhjen, ndarjen dhe transportimin e mbeturinave.

7. Kriteret për përcaktimin e zonave sipas paragrafit 6, të këtij neni e bënë komuna

Neni 11

Pikat mbledhëse për mbeturinat nga paisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme

1. Komuna zgjedh/cakton një pikë mbledhëse të grumbullimit të mbeturinave në vendbanimet rurale

2. Komuna zgjedh/cakton nje pike mbledhese te grumbullimit te mbeturinave ne vendbanimet urbane

3. Pikat mbledhëse për mbledhje të mbeturinave duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) të posedon sipërfaqe të mjaftueshme për mbledhje të mbeturinave; sipërfaqja të jetë e asfaltuar apo betonuar;
- b) të posedon infrastrukturën tekniko ndërtimore dhe objektet përcjellëse;
- c) të posedon zyrën e personelit për pranimin e mbeturinave;
- d) të posedon peshoren për matje të mbeturinave;
- e) të posedon kontejner të mjaftueshëm për hedhje të mbeturinave;
- f) të posedon objekte apo hapësira tjera të mbuluara për manipulim me mbeturina

Neni 12

Dorëzimi i mbeturinave komunale

1. Të gjithë personat fizik dhe juridik, që krijojnë mbeturina, kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave komunale.

2. Për shërbimin e ofruar, sipas paragrafit 1, të këtij neni, duhet të paguajnë;

- a) personat fizik dhe juridik
- b) amviserite dhe bizneset
- c) institucionet publike
- d) industrite dhe subjektet tjera

3. Prodhuesi i mbeturinave detyrohet, që mbeturinat t'i ndaj dhe t,i vendos sipas sistemit të përcaktuar nga komuna

4. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për mbledhjen e mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara për to, sipas Ligjit te Mbeturinave

Neni 13

Dorëzimi mbeturinave të konstruktim/demolimit

1. Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, personat duhet t,i largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë.

2. Dorëzimi i mbeturinave të krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën deri 0.1 m^3 mund të hedhen në kontejnera 5m^3 , 4000 kg për mbeturina inerte, sipas paragrafit 6 të kësaj Rregulloreje.

3. Dorëzimi i mbeturinave të krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën mbi $1/10 \text{ m}^3$ është e rregulluar me Udhëzimin administrativ për Mbeturinat nga Konstruktimi dhe Demolimi, me nr. 05/07.

4. Transportimi i këtyre mbeturinave bëhet nga vetë prodhuesit ose operatorët për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në deponite e caktuara nga komuna.

Neni 14

Obligimi i prodhuesve të mbeturinave komerciale

1. Prodhuësit të mbeturinave komerciale të regjistruar dhe të identifikuar nga Komuna janë të obliguar ta informojnë Komunën/Operatorin mbi sasinë e gjeneruar të mbeturinave dhe llojin e tyre.

2. Mvarësisht nga lloji i mbeturinave prodhuësi komercial i mbeturinave obligohet në pëmbushjen e kushteve të caktuara në bazë të marrëveshjes me operatorin si të pajiset me kontejnerë/shporta adekuate për grumbullimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

Neni 15

Ndërprerja e operimit për mbledhjen e mbeturinave

1 Ndërprerja e aktiviteteve të operatorit për mbledhjen e mbeturinave bëhet vetëm atëherë kur operatorin nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara në kontratë

2. Para se të ndërpritet kontrata komuna njofton operatorin me shkrim lidhur me shkeljen e bërë, jep vërejtjet, propozon masat dhe cakton afatin kohor për zbatim të kushteve të kontratës

3. Me rastin e ndërprerjes së kontratës, operatorin i ndalohet aktiviteti për mbledhjen e mbeturinave

Neni 16

Detyrat e inspektorit mjedisor dhe komunal

1. Inspektori mjedisor dhe komunal mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës përkatëse, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit

Neni 17

Tarifat

1.Komuna e përcakton mënyrën dhe formën e caktimit të tarifës për mbeturina me Rregullore të veqante për tarifa dhe ngarkesa.

2. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse përcaktojnë mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale

Neni 18

Ruajtja e të dhënave personale

1. Për qëllim të planifikimit, llogaritjes së tarifave të nevojshme, lejohet që të ruhen dhe përpunohen informatat mbi konsumatorët

2. Sa i përket pronësisë në qytet mbledhen, ruhen dhe përpunohen informatat vijuese:

- Numri i parcelës dhe adresa,
- Numri, lloji i biznesit dhe njësive rezidenciale të banimit,
- Emri dhe adresa e pronarëve të pronave apo të personave tjerë titullarë

3.Konsumatorët e afektuar nga mbledhja e të dhënave kanë të drejtë sipas Ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale që të kërkojnë qasjen në të dhënat e mbledhura si dhe për të korrigjuar të dhënat e pasakta.)

Neni 19

Dispozitat ndëshkuese

1.Me gjobë në shumë prej 5 deri në 100 Euro për personat fizik dhe juridik zbatohen dispozitat ndëshkuese të Udhëzimit Administrativ nr.04/2009 mbi ndëshkimet me gjoba mandatore , të hartuar nga MMPH

Neni 20


Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Për zbatimin e dispozitave ndëshkuese të kësaj rregulloreje janë kompetente Inspekcioni mjedisor dhe Komunal, Policia e Kosovës si dhe Gjykatat Komunale

Hyrja në fuqi

Neni 21

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Kuvendi Komunal të datës _____ 2012

Kryesusi i Kuvendit

Naim Bazaj

